REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.83, datë 29.10.2026

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI I SKRAPARIT", PAS VDEKJES Z.QEMAL MANÇE

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 29.10.2026, mori në shqyrtim projektaktin e mbështetur në ligjin nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, mbështetur në ligjin nr.139/2015, "Për Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 8,9 dhe 11 të ligjit nr.94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë", si dhe Vendimin nr.609, datë 15.10.2026 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

VENDOSI:

Ti jepet titulli "Qytetar Nderi i Skraparit" pas vdekjes, z.Qemal Mançe, me motivacion:

"Në shenjë mirënjohje për pjesëmarrjen aktive në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, për sakrificën e tij në mbrojtje të lirisë së atdheut. Drejtues i spikatur që në çdo skaj të Shqipërisë punoi me përkushtim,ndershmëri dhe ndërgjegje të lartë për rindërtimin, në vepra të rëndësishme për ekonominë e vendit. Personalitet, i cili me veprimtarinë e tij publike ka promovuar, transmetuar dhe mbajtur lart vlerat dhe virtytet më të mira të krahinës së Skraparit".

Vendimi u miratua me 12 Vota pro, vota kundër - 1 , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Elsa PETRITAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SKRAPAR

Rruga: "Pasho Hysi" Lagjja: "Çlirimi" Çorovodë, Skrapar Telefon: +355 31222512email:bashkiacorovode@ymail.com